

AKT - THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “PALMA CONSTRUCTION.p.k.

Në mbështetje të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit nr.7667, datë 28.1.1993, “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, ne te quajturit:

1. **Aida Piranej** e bija Edmor.dit me dt 15.11.1973,banues ne rrugen ‘Alqi Kondi’ Lagjja Perash,pallati nr.1185 ,Shkoder.
2. **Iliriana Çoçoli(Demiraj)** e bija e Nazmiut e datelindjes 11.11.1949,banuese ne rrugen “Kristaq Kostaq Mema” Nr.3/1.Tirane.

Vendosi të krijoje shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“PALMA CONSTRUCTION” sh p k** si më poshtë vijon :

Neni 1

Ortakët e mesiperm vendosen te krijojne shoqërine me përgjegjësi të kufizuar (shpk) me emërtimin **“PALMA CONSTRUCTION”** me ortakë Aida Piranej me 80% te kuotave te kapitalit te pergjithshem dhe Iliriana Çoçoli(Demiraj)me 20 %te kuotave te kapitalit te pergjithshem.....

Neni 2

Selia e shoqerise” **“PALMA CONSTRUCTION” sh p k**, do të jetë në Shkoder .

Neni 3

Shoqeria **“PALMA CONSTRUCTION “sh p k** ka te drejte te krijoje filiale te saj brenda dhe jashte vendi ne cdo kohe qe te cmohet e arsyeshme prej saj me aprovim te organeve kopetente

Neni 4

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kopetente te shtetit dhe do vazhdoje per nje periudhe kohore mbi 10 vjet. Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate ,nese ortakët me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjasin kete afat. Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj para afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni,nese per kete merr vendim te ortakëve te kesaj shoqerie .

Neni 5

Shoqeria "PALMA CONSTRUCTION" sh.p.k. gezon statusin e personit juridik . Veprimtaria e saj do zhvillohet sipas dispozitave te ketij akt themelimi ,statusit te saj dhe legjislacionit ne fuqi .Statusi I shoqerise I bashkangjitet ketij akti themelimi dhe eshte pjese pjese perberese e saj.

NENI 6

Shoqeria "PALMA CONSTRUCTION" sh.p.k. do të ushtrojë veprimtari tregtare private sipas përshkrimit që bëhet si me poshte:

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jete :

1. Tregti me shumice e pakice materiale tekstilësh (import export)
2. Tregti me shumice dhe pakice import eksport te artikujve te ndryshem ushqimore, industriale ,elektro shtepijake , prodhim konfeksionesh tregtim dhe prodhim produkte bujqesore dhe blagtorale ,pije freskuese dhe alkoolike,materiale ndertimi ,inerte ,parafabrikate ,hidrosanitare ,ndertim, montim,vegla auto,makineri e paisje pjese kembimi ,autoshkolla ,lavazh ,bilardo bar kafe ,restorant ,zyre konsulence ne fushen juridike ,financiare ,hartim e zbatim projektesh ,agjensi per shitblerje ,dhenie me qera pasuri te lujteshme dhe te palujteshme ,agjensi komisionere si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe pasagjereve brenda dhe jashte vendit ,prodhime duralumini dhe tregtim te tyre,sherbime robaqepse,prodhime dhe cdo gje tjeter qe lejohet me ligj
2. Import -export materiale te te gjitha llojeve
 1. Agjensi udhetimesh dhe turistike , sherbime hotelerie, bar restorant,fast food, transport mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit .Shitje Bileta avioni,trageti etj ,siguracione te ndryshme te prones ,shendetit , mjeteve etj,sherbime taxi.Sherbim autoshkolle.
3. Punime ndertimi:Germime dheu me punime eventuale muraturee beton arme – orishje dhe punime ne toke te germuar,prodhime material ndertimi,ndertime civile dhe ekonomike,ndertime rrugore,ndertime hekurudhore,ndertim ura dhe vepra arti,ndertime detare,ndertime hidraulike e hidroteknike,vepra te vecanta e punime speciale,punime restaurimi,punime karpentiere,impiante teknologjike dhe te vecanta,punime montim ne impietet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise,punime sherbimi,punime topogjeodezike.
4. Punime projektimi:Projektues urbanist,arkitekt,konstruktor,instalator,,vepra hidraulike,rruge-hekurudha,uradhe vepra arti,gjeodet,studim gjeollogo inxhinierik-hidrogjeollogjik,projektim i impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise. hidrogjeollogjik,projektim i impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise.
5. Veprimtari per laboratore te kontrollit te materialeve te ndertimit dhe klasifikimi i tyre
 - Laboratore te materialeve te ndertimit L1-MN
 - Laboratori i provave te Strukturave te Ndertimit L2SN
 - Laboratore gjeoteknik L3GJT GJ
6. Mbikqyerje kolaudim punimesh:ne punime civile dhe industriale,rrugore dhe hekurudhore,vepra arti,hidraulike dhe hidroteknike,punime instalimi,punime teknologjike dhe te montimit.punime sherbimi,puse-CPIME gjeologo inxhinierike-

Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi do kryeje cdo operacion tregtar e financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Shoqeria mund te hape edhe veprimtari te reja ,te krijoje ose te marre pjese ne sipermarrje te tjera si brenda ashtu edhe jashte vendi,pa cenuar objektin kryesor te shoqerise

Shoqeria ka ndermend te realizoje inisiativa te reja produktive konform ligjit ne teritorin shqiptar duke perfituar nga perjashtimet fiskale dhe kredite nxitese te parashikuara.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 lekë . Ky kapital mund të ndryshojë me vendim te ortakeve te shoqerise

Neni 8

Fitimi neto qe do realizohet nga veprimtaria e shoqerise do I kaloje ortakeve te kesaj shoqerie .

NENI 9

Per detyrimet qe do krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie ,kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj.Ortaket nuk mbajne pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e tyre qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie

Neni 10

Nuk mund te pranohet ne kete shoqeri si ortak nje person I trete papelqimin e ortakeve

Neni 11

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin konfidencial te aktivitetit te shoqerise.

Ortaku qe shkel detyrimin e mesiperm dhe nga kjo shkelje shoqerise I shkaktohet nje dem,eshte I detyruar te shperbleje demin.

Neni 12

Marrdheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.

Neni 13

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet shoqërisë dhe të punësuarve do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt zgjidhja e tyre është në kompetencë të Gjykatës Tiranë.

Neni 14

Ortaket kane te drejta kryesore te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra nga Asambleja e ortakeve.

- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarive ekonomiko-tregtare te shoqerise,ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te kerkojne dhe tu jepen te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria (bilanci,libra llogarie).
- Te bejne propozime dhe ti paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe asamblese se shoqerise.
- Administrator I shoqerise eshte ortaku Zj.Aida PIRANEJ.
- Te heqin dore nga shoqeria ne kushtet qe percaktohen ne kontrate dhe ne kete statut.

Neni 15

Akti Themelimit përpilohet në katër kopje origjinale, të cilat i jepen organeve përkatëse sipas kërkesave të ligjit dhe një kopje e tij mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

THEMELUESIT

Aida PIRANEJ

Aida Piranej (Piranej)

Iliriana ÇOÇOLI (DEMIRAJ)

Iliriana Çoçoli (Demiraj)



STATUT

I SHOOËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “PALMA CONSTRUCTION” sh. P. k.

KREU I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “**PALMA CONSTRUCTION**” sh.p.k themelohet ne perputhje me ligjin 7638 date 19.11.1992”Per Shoqerite Tregtare” .

Kjo shoqeri krijohet nga ortakët :

1.Aida Piranej,e bija Edmondit me dt 15.11.1973,banues ne rrugen ‘Alqi Kondi’ Lagjja Perash,pallati nr.1185,Shkoder.

2.Iliriana Çoçoli(Demiraj) e bija e Nazmiut e datelindjes 11.11.1949,banuese ne rrugen “Kristaq Kostaq Mema” Nr.3/1.Tirane.
e paisur me pasaporte me nr .Z.0604046:....

Shoqeria do njihet me emrin “**PALMA CONSTRUCTION**” sh p.k

Ajo e ka seline ne,Shkoder.

Shoqeria ka te drejte te cele filiale ,dege, perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise e jashte saj ,ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ato te vendeve te tjera ku ato do te hapen.

Administrator I shoqerise do jete Zj.Aida Piranej :...

Neni 2

Shoqeria “**PALMA CONSTRUCTION**” sh p.k e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj (kontrates dhe ketij statuti).

Kjo shoqëri eshte person juridik .Ajo e fiton te drejten e personit juridik nga data e rregjistrimit ne Gjykate

Neni 3

Shoqeria “**PALMA CONSTRUCTION**” sh p.k ushtron veprimtarinë ekonomike për një periudhë mbi 10 vjet pa ndërprerje.

Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate ,nese ortaku me vullnetin e tij te lire e te plote nuk e zgjat kete afat.

Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj para afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni,nese per kete marrin vendim ortakete shoqerise .

Neni 4

Shoqeria “**PALMA CONSTRUCTION**” sh p.k per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet,pergjigjet vetem me pasurine e saj.

Pjesmarrja ne kete shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore organizative dhe te drejta pronesia jashte kesaj shoqerie.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria "PALMA CONSTRUCTION" sh p.k do kete si objekt :

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jete :

1. Tregti me shumice e pakice materiale tekstilesh (import export)

2.Tregti me shumice dhe pakice import eksport te artikujve te ndryshem ushqimore,industriale ,elektro shtepijake , prodhim konfeksionesh tregtim dhe prodhim produkte bujqesore dhe blegtorale ,pije freskuese dhe alkoolike,materiale ndertimi ,inerte ,parafabrikate ,hidrosanitare ,ndertim, montim,vegla auto,makineri e paisje pjese kembimi ,autoshkolla ,lavazh ,bilardo bar kafe ,restorant ,zyre konsulence ne fushen juridike ,financiare ,hartim e zbatim projektesh ,agjensi per shitblerje ,dhenie me qera pasuri te lujteshme dhe te palujteshme ,agjensi komisionere si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe pasagjereve brenda dhe jashte vendit ,prodhime duralumini dhe tregtim te tyre,sherbime rrobaqepse,prodhime dhe cdo gje tjeter qe lejohet me ligj

2. Import -export materiale te te gjitha llojeve

1.Agjensi udhetimesh dhe turistike , sherbime hotelerie, bar restorant,fast food, transport mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit .Shitje Bileta avioni,trageti etj ,siguracione te ndryshme te prones ,shendetit , mjeteve etj,sherbime taxi.Sherbim autoshkolle.

3.Punime ndertimi:Germime dheu me punime eventuale muraturee beton arme – orishje dhe punime ne toke te germuar,prodhime material ndertimi,ndertime civile dhe ekonomike,ndertime rrugore,ndertime hekurudhore,ndertim ura dhe vepra arti,ndertime detare,ndertime hidraulike e hidroteknike,vepra te vecanta e punime speciale,punime restaurimi,punime karpentiere,impiante teknologjike dhe te vecanta,punime montim ne impietet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise,punime sherbimi,punime topogjeodezike.

4.Punime projektimi:Projektues urbanist,arkitekt,konstruktor,instalator,,vepra hidraulike,rruge-hekurudha,uradhe vepra arti,gjeodet,studim gjeollogo inxhinierik-hidrogjeollogjik,projektim i impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise.

5.Veprimtariper laboratore te kontrollit te materialeve te ndertimit dhe klasifikimi i tyre

 Laboratore te materialeve te ndertimit L1-MN

 Laboratori i provave te Strukturave te Ndertimit L2SN

 Laboratore gjeoteknik L3GJT GJ

6.Mbikqyerje kolaudim punimesh:ne punime civile dhe industriale,rrugore dhe

hekurudhore,vepra arti,hidraulike dhe hidroteknike,punime instalimi,punime teknologjike dhe te montimit,punime sherbimi,puse-cpime gjeologo inxhinierikie-cpime per uje Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi do krveie cdo operacion tregtar e financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me

objektin e saj. Shoqëria mund të hapë edhe veprimtari të reja, të krijojë ose të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera si brenda ashtu edhe jashtë vendi, pa cenuar objektin kryesor të shoqërisë

Shoqëria ka ndermend të realizojë inisiativa të reja produktive konform ligjit në territorin shqiptar duke përfituar nga përjashtimet fiskale dhe kredite nxitesë të parashikuara.

KREU II

MARRDHENIET EKONOMIKO – FINANCIARE

NENI 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqindmijë) lekë

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij janë të transferueshme si ndërmjet ortakëve tek të tretët. Transferimi i kapitalit ose i pjesëve të tij të një personi i tretë bëhet gjithmone me akt noterial.

Te gjitha veprimet e shoqërisë mbi kapitalin themeltar behen me miratimin e ortakëve. Vlerësimi i kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marrëveshje të vecantë ose nga një ekspert kompetent i caktuar nga asambleja e ortakëve

Neni 7

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar në teresi ose vecanti bëhet me vendim të asamblese së ortakëve

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjister të vecantë.

Neni 8

Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë i takon ortakëve.

Neni 9

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në baze të leverdive ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit të shoqërisë duhet të perfundojë brenda muajit mars të vitit pasardhës. Bilanci i aktivitetit financiar mund të bëhet nga vete ortakët ose nga eksperte të caktuar prej tyre. Por në të gjitha rastet rezultatet e bilancit financiar duhet të behen të njohur çdo ortak dhe gjithmone rezultati perfundimtar duhet të merret në shqyrtim nga asambleja e ortakëve, brenda 6 muajsh nga dita e mbydhjes së vitit financiar.

Neni 10

Shoqëria krijon fondet e saj për zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit të saj, në përputhje me rregullat në fuqi, përberja e fondeve, burimet financiare të tyre, caktohen nga asambleja e ortakëve.

Neni 11

Shoqeria disponon plotesisht mjetet e saj financiare

KREU III

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI 12

Ortakët kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nepermjet vendimeve të marra nga Asambleja e ortakëve .

- Te marrin pjesë në administrimin e veprimtarive ekonomiko –tregtare të shoqërisë, në përputhje me kontratën dhe statutin .
- Te kërkojnë dhe të japin, të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga
- shoqëria (bilanci, libra llogarie).
- Te bëjnë propozime dhe të paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblesë së Shoqërisë.
- Te heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.

Neni 13

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

- Te depozitojnë kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe me vendimet e Asamblesë.
- Te marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nepermjet organeve të krijuara nga ata vetë.
- Te kryejnë detyrimet e ngarkuara nga Asambleja ose Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

NENI 14

Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve .

Në asamble marrin pjesë ortakët .

Asambleja e ortakëve vendos për këto probleme:

1. Miraton bilancin vjetor të shoqërisë.
2. Vendos shtimin ,pakesimin ose transferimin e kapitalit themelor .
3. Emeron dhe shkarkon administratorin e shoqërisë. Ku në këtë rast është emëruar administrator i shoqërisë Aida Piranej.
4. Ben modifikimin në kontroll dhe statut sipas ecurisë së shoqërisë.
5. Vendos për mbydhjen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e shoqërisë.

Neni 15

Administratori I shoqerise ka te gjitha kopetencat per te vepruar ne emer e per llogari te shoqerise ne marrdheniet me personat e trete.

Administratori nuk mund te kryeje vetem ato detyra qe I jane lene per kopetence nga Asambleja e ortakeve.

Shoqeria merr persiper te gjitha pasojat qe mund te vijne nga veprimet e administratorit.

Neni 16

Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete ,kur gjate veprimtarive te tyre shkelin ligjin ,kontraten dhe statutin ,ose per shkelje te kryera gjate administrimit te shoqerise

Neni 17

Marrdheniet e punes me punetoret qe do te punesohen prane shoqerise "PALMA CONSTRUCTION" sh p.k. rregullohen me kontrata individuale ,qe do te lidhen me secilin prej tyre..

KREU V

MBYLLJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

Neni 18

Veprimtaria e shoqerise pushon me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontrate ne qoftese ortaket me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjatin kete afat..

Ajo mund te pushoje veprimtarine e saj edhe para afatit te parashikuar ne kontrate kur per kete marrin vendim te gjithe ortaket.

Veprimtaria e shoqerise pushon edhe ne ato raste kur ortaket vendosin shnderrimin e shoqerise nga SHPK ne nje lloj shoqerie tjeter .

Neni 19

Kur shoqeria likujdohet plotesisht ,Asambleja krijon komisionin e likujdimit I cili paraqet bilancin e likujdimit .

Pasuria e shoqerise ,pasi shlyhen detyrimet e shoqerise .

Pasuria qe eshte futur ne shoqeri me te drejte shfrytezimi I kthehet pronareve te saj .

Dispozita të fundit

Neni 20

Ky statut u përpilua në katër kopje origjinale, të cilat i jepen organeve përkatëse sipaskërkesave të ligjit dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKET

Aida Piranej

Aida Piranej
Piranej

Iliriana Çoçoli(Demiraj)

Iliriana Çoçoli (Demiraj)
[Signature]